



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1509/11 prot.

Datë 08.07.2025

V E N D I M

Nr. 873/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anetar

Në mbledhjen e datës 08.07.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 814/2025, datë 25.06.2025 për procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-47326-05-08-2025, me objekt “Blerje hipoklorit kalciumi dhe natriumi”, me fond limit 1,500,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 26.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjirokaštër SH.A.

Ankimues: Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me NIPT M11815028I dhe adresë: Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6.

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjirokaštër SH.A.
Rruga Muharrem Gega "Nd.24, Hy. 1, Gjirokaštër.

Subjekte të interesuar: Operatori ekonomik “2 AT” SHPK me NIPT K14019001H dhe adresë: Zona kadastrale 1101, numër pasurie 262/82, v. Dishnicë, Korçë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik

nr.766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave
“Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të
Prokurimit Publik”* .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 25.06.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.814/2025, ku vendosi:
[...]

1. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Albanian Distribution Chemicals” SHPK në procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-47326-05-08-2025, me objekt “Blerje hipoklorit kalciumi dhe natriumi”, me fond limit 1,500,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 26.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastrë SH.A.*
2. *Të anulohet shortin e datës 30.05.2025 për procedurën e sipërpërmendur të prokurimit*
3. *Autoriteti kontraktor të rikthejë procedurën e prokurimit në momentin pas vlerësimit të ofertave dhe të vijojë me procedurën e hedhjes së shortit.*
4. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.*
5. *Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albanian Distribution Chemicals” SHPK.*
6. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2 Me shkresën nr. 1572 prot., datë 02.07.2025, protokolluar me tonën nr. 1509/8 prot., datë 04.07.2025 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 814/2025, datë 25.06.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-47326-05-08-2025, me objekt “Blerje hipoklorit kalciumi dhe natriumi”, me fond limit 1,500,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 26.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastrë SH.A.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1.Me shkresën nr. 1572 prot., datë 02.07.2025, protokolluar me tonën nr. 1509/8 prot., datë 04.07.2025 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 814/2025, datë 25.06.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr.

REF-47326-05-08-2025, me objekt “Blerje hipoklorit kalciumi dhe natriumi”, me fond limit 1,500,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 26.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër SH.A.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se autoriteti kontraktor nuk ka kryer rikthyer procedurën e prokurimit në momentin pas vlerësimit të ofertave, për të vijuar më tej me hedhjen e shortit, sipas konstatimeve të shprehura në vendimin nr.814/2025 të këtij Komisioni.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-47326-05-08-2025, me objekt “Blerje hipoklorit kalciumi dhe natriumi”, me fond limit 1,500,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 26.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër SH.A.
2. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

